



*KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.

Procedura për provizionimin e llogarive të arkëtueshme



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh. a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Hyrje

Qellimi i kesaj procedure eshte rregullimi i procesit te provizionimit te llogarive te arketueshme sipas kërkesave te Standardeve Ndërkombëtare te raportimit Financiar 9 dhe të sigurojë trajtim për klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Përcjellja dhe menaxhimi i shitjeve me afat te pagesës do behet ne përputhje me Procedurën për menaxhimin dhe kontrollin e te hyrave.

Vjetërsia e llogarive te arkëtueshme

Korporata Energjetike e Kosoves kategorizon llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera bazuar në vjetërsinë e tyre dhe njih humbjet e pritshme nga shitjet me afat te pagesës për të arkëtueshmet duke vlerësuar flukset e ardhshme të parave për secilën llogari te arketushme dhe duke vlerësuar një gamë të rezultateve të mundshme bazuar në përvojën historike për dymbëdhjetë muaj të humbjes nga shitjet me afat te pagesës sipas klientit, rajonit gjeografik, natyrës se shitjes dhe duke e aplikuar në llogarite e arketueshme te mbajtura në fund të vitit.

Për shkak se çdo e arkëtueshme mbart me vete një rrezik të paracaktuar, prandaj çdo llogari e arketueshme ka një humbje të pritshme bashkëlidhur asaj. Humbjet e pritura nga shitjet me afat te pageses duhet të llogariten për afatet e mundshme për 12 muajt e ardhshëm.

Për të njohur humbjet e mundshme, kompania duhet të llogarisë vjetërsinë e saktë të arkëttimeve tregtare për çdo klient.

Kalkulimi i humbjeve nga shitjet me afat

Llogaritja e humbjeve të shkaktuara nga shitja me afat të pagesës do bëhet në baza vjetore sipas metodës më poshtë:

Vjetërsia	Humbja e aplikuar
0 - 60 ditë	0 %
60 - 120 ditë	5 %
120 - 180 ditë	10 %
180 - 365 ditë	30 %
Mbi 365 ditë	100%

Inkasimi i llogarive të arkëtueshme të provizionuara

Me rastin e inkasimit të llogarive të arkëtueshme të provizionuara të njëjtat do të njihen tek të hyrat në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në vitin që janë inkasuar.

Shlyerja e llogarive të arkëtueshme të provizionuara

Llogarite të arkëtueshme të provizionuara do shlyhen nga librat kontabël pasi të merret aprovimi i zyrës ligjore se të njëjtat nuk mund të mbledhen përmes instrumenteve ligjore.

Llogarite të arkëtueshme të shlyera dërgohen për aprovim tek bordi i drejtoreve.

Data e hyrjes në fuqi

Kompania obligohet të zbatojë këtë procedurë për pasqyrat financiare për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2019 e në vijim.



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

15-04-2020

Nr. 1554

PRISHTINË-A

Bordi i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.

Ne mbështetje të dispozitave nga Rregulloret e ndërmarrjes, neni 4 i kreut III, që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, dhe duke vepruar konform dispozitave aty përkitazi me vendimmarrjen jashtë takimit dhe sipas regjistrimit të rregullt nga Sekretari, Bordi i Drejtorëve me dt. 17 mars 2020, ka vendosur si me poshtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR PROVIZIONIMIN E LLOGARIVE TE ARKËTUESHME

Ne pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij për udhëheqjen e ndërmarrjes, si dhe Pasi ka pranuar rekomandimin e njëjtë nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve, Bordi i Drejtorëve miraton Procedurën për provizionimin e llogarive të arkëtueshme, si është prezantuar.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

Shtojcë: *Procedura për provizionimin e llogarive të arkëtueshme, versioni i miratuar, versioni i miratuar*

Zt. Faruk Hajrizi
Kryesues



Datë
18 mars 2020